

Ballina | [Opinione](#) | Dr. Liridon Lika: Një shtet federal...

Dr. Liridon Lika: Një shtet federal...

15 April, 2015 06:28:00

Madhësia: - +

Një shtet federal, si një mundësi për barazi dhe respekt për të gjithë qytetarët: modeli belg si burim frymëzimi për Maqedoninë?

Liridon Lika, asistent/ligjërues dhe kandidat për doktoraturë në Qendrën për Studime të Marrëdhënieve Ndërkombëtare të Universitetit të Liezhit (Belgjikë).

Maqedonia mbetet një nga vendet më të paqëndrueshme në rajonin e Ballkanit Perëndimor, teatër i përlëshjeve të shpeshta etnike, veçanërisht që nga ardhja në pushtet e liderit nacionalist dhe autokratik Nikolla Gruevski. Marrëveshja e Ohrit nuk është duke u respektuar pothuajse aspak, gjë që ka bërë që Shqiptarët e këtij shteti të jenë të diskriminuar në të gjitha fushat, duke përfshirë edhe atë të ndarjes së pushtetit. Shqiptarët nuk përfaqësohen drejt në asnjë institucion shtetëror edhe pse përbëjnë të paktën një të tretën e popullsisë së përgjithshme. Thënë ndryshe, asnjë pozitë shtetërore me rëndësi nuk udhëhiqet nga këta të fundit. Pra, duke filluar nga Kryetari i Republikës, Kryetari i Kuvendit, Kryeministri, Ministri i Punëve të Jashtme, Shefi i shtabit të përgjithshëm të ushtrisë apo edhe guvernatori i Bankës kombëtare, që të gjithë janë Sllavo-maqedon. Për më tepër, gjuha shqipe gjithashtu nuk respektohet ashtu si duhet në asnjë nga këto institucione shtetërore. Përveç kësaj, ndikimi politik mbi gjykata sikurse në rastin « Monstra » ku qytetarët e pafajshëm dënohen me burgim të përjetshëm, por edhe shumë raste të tjera si ky, përbëjnë një diskriminim dhe mosrespektim të tmerrshëm të të drejtave të Shqiptarëve autoktonë në këtë vend. Për këtë arsye shndërrimi i Maqedonisë nga një shtet unitar në një shtet federal të bazuar mbi modelin federal belg ndoshta do të mund të jetë zgjidhja më e mirë momentale e cila do të barazonte plotësisht Shqiptarët me Sllavo-maqedonët. Prandaj, ky shkrim ka për qëllim të paraqes në pika të shkurtëra modelin federal belg nga i cili do të mund të frymëzohej Maqedonia.

Cili është dallimi ndërmjet një shteti federal, unitar dhe konfederatës ?

Në një shtet federal, ndarja e pushtetit bëhet në mënyrë që autoriteti qendror dhe njësitë (entitetet) federative të jenë autonome në sferat e tyre përkatëse. Shtetet federale mund të lindin veçanërisht në dy mënyra të ndryshme. Për shembull, lindja e federatës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës është bërë sipas parimit të federalizmit përmes bashkimit. Sipas kësaj formule, disa shtete sovrane bashkohen për të miratuar një Kushtetutë të përbashkët që do të shërbej si bazë për shtetin e ri federal. Një lloj i tillë i federatës lind në përgjithësi për shkak të kërcënimeve të jashtme siç është lufta.

Mënyra tjetër e krijimit të federatës është federalizmi përmes shkëputjes (ndarjes) që është krejtësisht e kundërta e modelit të përmendur më lartë. Sipas kësaj forme, një shtet unitar transformohet në disa entitete federative duke e ndryshuar Kushtetutën e tij. Ky lloj modeli ofron mundësinë për përforcimin e demokracisë, barazinë në mes popujëve, mbrojtjen e minoriteteve, apo realizimin e aspiratave autonomiste rajonale në fushën e gjuhës, kulturës apo edhe ekonomisë. Përmes këtij procesi, shteti unitar e ndryshon strukturën e brendshme dhe shndërrohet në një shtet federal.

Ndërsa, shteti unitar është ai në të cilin pushteti shtetëror është i përqendruar në duartë e një qeverie të vetme që ushtron plotësisht fuqinë publike në tërë territorin e saj. Në rastin e shtetit unitar autoriteti qendror ka kontrollin e plotë hierarkik mbi njësitë lokale (komunat, provincat). Pra, shteti unitar nuk e ndanë sovranitetin, por e përqendron në qendër. Ky lloj shteti mund të jetë relativisht i decentralizuar por çdogjë mund të ndryshoj në çdo kohë në mënyrë të njëanshme nga ana e autoritetit qendror. Në të vërtetë, komunat apo provincat në një shtet unitar mund të zhduken me vullnetin e thjeshtë të autoriteteve qendrore.

- Email mikut
- Verzioni print
- Tekst i thjeshtë

Votoni këtë tekst

0

Tjera nga: Opinione



"Akademik!", lëre rehat Shkupin?

Shkruan Musa Lamallari – Tim Shkupi Reagim për shkrimin e Akademikut "Ekstremizmi islam te shqiptarët" "Në Maqedoni do ta kisha nënvizuar dominimin e faktorit material dhe praninë



Nihilizmi i "islamistëve" të Besës në mbrojtje të Abdul Menaf Bexhetit

Një reagim të DSHM-së në lidhje me të bëmat faktike të Abdul Menaf Bexhetit e paska botuar dje portali Zhurnal. Si DSHM politikën e portalit ...



"Virgjireshat Katolike" të Unitarizmit në shtetin e Maqedonisë

Shkruan Musa Lamallari – Tim Shkupi III. WHAT ARE SOME COMMON WAYS CONSTITUTIONAL DEMOCRACIES ARE ORGANIZED? 1. UNITARY SYSTEMS. In

Rrjete sociale

DSHM on

DSHM

DSHM

Konfederata, nga ana tjetër, është një asociacion (bashkësi) e shteteve sovraane që zgjedhin të delegojnë një pjesë nga sovraniteti i tyre disa institucioneve të përbashkëta supranacionale në mënyrë që të ushtrojnë detyra specifike. Mirëpo, secili shtet anëtar ruan sovranitetin e tij dhe mund të marrë përsëri kompetencat e dhëna autoritetit më të lartë. Në rastin e konfederatës, shtetet anëtare e ruajnë cilësinë e tyre si subjekt i së drejtës ndërkombëtare.

Në rastin e Belgjikës kemi të bëjmë me një shtet që në ditët e sotme është federal por që në të kaluarën ishte shtet unitar. Pra, Belgjika ka njohur një federalizëm përmes shkëputjes.

Transformimi i Belgjikës nga një shtet unitar në një shtet federal

Modeli belg i sotshëm është një prodhim i një procesi të gjatë dhe të ngadalshëm të federalizimit të vendit që ka filluar në vitet 1960, por që shkaqet e shumëfishta duhet kërkuar disa dekada më herët. Në të vërtetë, që nga krijimi i Belgjikës si shtet i pavarur dhe unitar më 1830, nga një elitë frengjishtfolëse, kanë lindur konflikte ndërmjet dy Bashkësive të mëdha, Flamanëve në Veri që në atë kohë përbënin rreth 57 % të popullësisë së përgjithshme, dhe Valonëve në Jug që përbënin 42 % të saj. Ndërsa Gjermanët përbënin vetëm 1 % të popullësisë.

Në shtetin e ri belg, frengjishtja ishte gjuha e vetme zyrtare edhe pse popullata fliste dialekte holandeze në Veri, ndërsa latine në Jug. Me gjithë peshën demografike të Flamanëve (holandishtfolës) Belgjika do të qeveriset në tërë territorin e saj vetëm në gjuhën frënge. Kjo situatë politike do të krijoj pakënaqësi të mëdha në mesin e Flamanëve, të cilët ndiheshin minoritarë në një vend ku demografikisht përbënin 57 % të popullësisë. Si reagim i këtij dominimi gjuhësor të frengjishtës do të lind Lëvizja flamane e cila që pas shpalljes së pavarësisë do të kërkojë të drejtën e përdorimit të gjuhës holandeze në çështjet publike (arsim, gjykatë, administratë publike, ushtri, etj.), dhe do të bëjë përpjekje që të pengoj asimilimin e holandishtfolësve në Bruksel dhe rrethinën e tij.

Me kalimin e viteve gjërat filluan të ndryshojnë gradualisht. Gjatë viteve 1930 pati përparime të konsiderueshme në fushën e gjuhës sepse holandishtja bëhet gjuha e vetme zyrtare dhe e detyrueshme në Flandër në të gjitha fushat e jetës publike. Që nga kjo kohë, përdorimi i gjuhëve në Belgjikë është i rregulluar në bazë **territoriale**. Ky parim i territorialitetit do të « betonohet » kufirin gjuhësor dhe do të krijoj 4 rajone gjuhësore në vitin 1963 :

rajonin gjuhësor gjermanishtfolës ;
rajonin gjuhësor frengjishtfolës ;
rajonin gjuhësor holandishtfolës ;
rajonin dygjuhësor i Brukselit_

Në vitet 1960 situata ekonomike në Belgjikë njehej një kthesë madhore. Valonia, që kishte qenë për dekada me radhë motorri i ekonomisë belge, preket rëndë nga kriza, ndërsa në të njëjtën kohë ekonomia flamane njehej një lulëzim të madh. Si përgjigje ndaj krizës që njehej Valonia, një levizje e quajtur Lëvizja valone zhvillohet me shpejtësi dhe kërkon një autonomi ekonomike rajonale e cila mendohej se do t'i lejonte të ballafaqohet më mirë në përmirësimin e gjendjes së rëndë ekonomike. Duhet theksuar gjithashtu se Frengjishtfolësit frigoeshin se do të bëheshin minoritet edhe më i vogël në nivel kombëtar, sepse pas Luftës së Dytë Botërore prirjet demografike ishin më të favorshme për Flamanët të cilët shënonin rritje të popullësisë.

Kështu që kemi **dy kërkesa autonomiste**, njëra gjuhësore dhe kulturore e Flamanëve, kurse tjetra kryesisht ekonomike e Valonëve. Këto dy kërkesa janë shkaktarë të transformimit progresiv të Belgjikës unitare drejt një shteti federal.

Federalizmi belg është i veçantë në llojin e tij sepse nuk ishte i bazuar në një projekt politik të qartë ose në ide politike të qarta, por lindi gradualisht dhe u zhvillua vetëm si një mënyrë pragmatike e tejkalimit të situatave të rënda momentale. Prandaj, çdo reformë është parë si diçka e përkohshme. Njësitë federative nuk janë njësi historike sepse nuk kanë ekzistuar para krijimit të Belgjikës. Për më tepër, reformat e para të vitit 1970 nuk e kishin për qëllim krijimin e një shteti federal, por vetëm shuarjen apo qetësimin e konflikteve territoriale dhe gjuhësore. Në fakt, në fillim të reformës së parë të shtetit më 1970, edhe shprehja federalizëm është urreyer nga shumëkush sepse tingëllonte si një lloj separatizmi apo ndarje e vendit.

Sidoqoftë, shteti belg është në reformim të përhershëm. Që nga vitet 1970 ka pasur jo më pak se 6 reforma të mëdha shtetërore. Ndër më kryesoret që ndryshuan themelet e shtetit janë si vijon : në vitin 1970 janë krijuar Komunitetet, në vitin 1980 janë krijuar Rajonet (dy rajone), dhe në vitin 1988 është krijuar Rajoni i Brukselit-Kryeqytet. Ndërsa, në vitin 1993 kemi një etapë të rëndësishme simbolike për shkak se për herë të parë futet në Kushtetutën belge neni i parë në të cilin shkruhet « Belgjika është një shtet federal që përbëhet nga komunitetet (bashkësitë) dhe rajonet (krahinat) ». Kështu që, federalizmi belg është i tipit centrifugal, që do të thotë se pas çdo reforme, një numër i mirë i kompetencave është transferuar nga niveli qendror drejt Bashkësive dhe Rajoneve.

Cila është struktura e shtetit belg ? Si funksionon modeli belg ?

Belgjika federale :

Belgjika është një mbretëri kushtetuese parlamentare ku qeveria është përgjegjëse para Parlamentit (vetëm para Dhomës së përfaqësuesëve prej vitit 1993). Në Belgjikë, pushteti vendim-marrës nuk është i centralizuar por i ndarë ndërmjet këtyre njësive :

Autoritetit federal (si diçka e përbashkët)
3 komuniteteve (bashkësive) dhe
3 rajoneve (krahinave)

Këto 3 nivele politike janë autonome, kanë kompetenca të rëndësishme dhe janë gjithashtu përgjegjëse për bashkëpunim ndërkombëtar, duke përfshirë edhe nënshkrimin dhe miratimin e traktateve të ndryshme.

Autoriteti federal

Niveli federal (autoriteti federal) vazhdon të mbajë gjithmonë disa kompetenca që kanë të bëjnë me të gjithë Belgët dhe të cilat ushtrohen në të gjithë vendin. Këtu përfshihen në mes të tjerash : politika e jashtme, mbrojtja kombëtare, drejtësia, komunikimi (posta dhe telekomunikacioni, ...), etj.

Pushteti legjislativ ushtrohet nga **Parlamenti federal**, i cili përbëhet nga dy dhoma: **Dhoma e Përfaqësuesëve** dhe **Senati**, si dhe nga **Mbreti**. Mbreti është i liruar nga të gjitha përgjegjësitë, mirëpo ministrat e tij bashkë-nënshkruajnë projektligjet dhe dekretet mbretërore të cilat votohen nga Parlamenti dhe kështu e marrin përgjegjësinë e plotë. Dhoma e përfaqësuesëve përbëhet nga 150 anëtarë të zgjedhur në mënyrë të drejtpërdrejt sipas sistemit proporcional. Në Belgjikë ka 11 zona zgjedhore (5 flamane, 5 valone dhe Brukseli si një zonë e vetme). Senati përbëhet nga 60 anëtarë, të zgjedhur në mënyrë të tërthortë (jo-drejtpërdrejt).

Pushteti ekzekutiv i takon **Qeverisë Federale** e cila përbëhet nga **Këshilli i ministrave** dhe **Mbreti**.

Komunitetet (Bashkësitë)

Komunitetet janë njësi politike të bazuara mbi gjuhën. Duke pasur parasysh që ka tri gjuhë zyrtare në Belgjikë, ka gjithashtu tri komunitete. Këto të fundit ushtrojnë kompetencat e tyre në rajonet gjuhësore si vijon :

Komuniteti flaman është kompetent në rajonin gjuhësor holandishtfolës (Flandër) dhe ushtron gjithashtu disa kompetenca në rajonin dygjuhësor të Brukselit.

Komuniteti francez është kompetent në rajonin gjuhësor frengjishtfolës (Valoni) dhe ushtron gjithashtu disa kompetenca në rajonin dygjuhësor të Brukselit.

Komuniteti gjermanishtfolës është kompetent në rajonin gjuhësor gjermanishtfolës (në dy kantonet e Lindjes).

Pra, Komunitetet janë kompetente veçanërisht në fushën e **gjuhës** (përdorimit të gjuhëve në administratë, arsim dhe raportet shoqërore), të **kulturës** (siç janë turizmi, sporti dhe rinia), të **sektorit audiovizual** dhe **arsimit** (përveç në 3 raste ku autoriteti federal është kompetent : për sa i përket fillimit dhe përfundimit të detyrimit shkollor, kushteve minimale për lëshimin e diplomave, dhe regjimit të pensioneve të personelit të punësuar në sektorin e arsimit). Secili komunitet ka Parlamentin dhe Qeverinë e vet.

Rajonet (Krahinat)

Belgjika është e ndarë në 3 Rajone :

Rajoni flaman
Rajoni i Brukselit (Brukselit-Kryeqytet)
Rajoni valon

Rajonet janë njësi territoriale. Për shembull, territori i Rajonit flaman përputhet me rajonin gjuhësor holandishtfolës. Territori i Rajonit valon përfshinë rajonet gjuhësore frengjishtfolëse dhe gjermanishtfolëse. Ndërsa, Rajoni i Brukselit është kompetent në rajonin dygjuhësor të Brukselit.

Rajonet ushtrojnë kompetencat e tyre në territoret e tyre përkatëse lidhur me **ekonominë, tregtinë e jashtme, punësimin, strehimin, transportin, mjedisin, politikat bujqësore, planifikimin e**

territorit dhe urbanizmin. Përveç kësaj, këto njësi federative janë gjithashtu kompetente në **marrëdhëniet ndërkombëtare** në suazat e fushave të tyre kompetente. Çdo rajon ka Parlamentin dhe Qeverinë e vet.

Megjithatë, në Flandër, Rajoni flaman dhe Komuniteti flaman janë shkrirë në një Parlament dhe Qeveri të vetme flamane. Pra, Bashkësia flamane ushtron kompetencat edhe të Bashkësisë por edhe të Rajonit. Shkrirja në mes të Bashkësisë Flamane dhe Rajonit flaman tregon qartë që Flandra mbron idenë e krijimit të një « shteti flaman » në gjirin e vet shtetit belg.

Modeli federal belg karakterizohet në të vërtetë nga një qendër e dobët, për të mos thënë e paralizuar nga antagonizmat midis dy komuniteteve. Për shembull, pas zgjedhjeve parlamentare federale të vitit 2007 u deshën **194 ditë** që të arrihet deri te formimi i qeverisë federale. Për më tepër, pas zgjedhjeve të vitit 2010, u deshën **541 ditë** që të arrihet marrëveshja për formimin e qeverisë federale, situatë që përbënë periudhën më të gjatë të krizës politike jo vetëm në Belgjikë por edhe në Europë. Prandaj, federalizimi i Belgjikës nuk do të thotë që ka pajtuar plotësisht të gjithë. Ende edhe sot ka pakënaqësi të ndryshme.

Mirëpo, ajo që ka bërë modelin belg të jetë i suksesshëm deri më tani është bashkëpunimi i elitave flamane dhe valone, pra sjelljet e tyre bashkëpunuese. Në Belgjikë kemi një **federalizëm konsociativ apo konsensual**. Demokracia konsociative apo konsensuale nuk lejon që grupi shumicë të dominoj grupin pakicë, por që të dy bashkëpunojnë sipas kompromisit. Baza e modelit konsociativ ishte ndarja në grupe gjuhësore, në mënyrë që të mbrohej minoriteti gjuhësor. Prandaj, u vendosë që të gjithë deputetët federal të ndahen në dy grupe gjuhësore : grupin holandishtfolës dhe grupin frengjishtfolës. Në këtë mënyrë deputetët holandishtfolës përfaqësojnë elektoratin holandishtfolës, ndërsa deputetët frengjishtfolës përfaqësojnë elektoratin frengjishtfolës dhe gjermanishtfolës (meqenëse këta të fundit janë një pakicë shumë e vogël).

Pra, në Belgjikë kemi një logjikë bipolare (dualiste) të përfaqësimit ku secili grup duhet të përfaqësohet nga elitat e veta politike. Kjo do të thotë që në Belgjikë nuk ka parti politike federale, por partitë politike belge prezantohen në zgjedhje vetëm në rajonin e tyre gjuhësor.

Tre mekanizmat mbrojtës

Ndarja në dy grupe gjuhësore në Parlamentin federal ka bërë që të instalohen tre mekanizma mbrojtës : dy në nivelin legjislativ dhe një në nivelin ekzekutiv.

1. Që nga viti 1970 ekziston **ligji me shumicë speciale**, që kërkon **2/3** e parlamentarëve, por gjithashtu edhe një « **shumicë të dyfishtë** » në të dy dhomat legjislative, që do të thotë një shumicë të thjeshtë në të dy grupet gjuhësore. Për shembull, çdo reformë shtetërore duhet të bëhet përmes kësaj shumice speciale.
2. Procedura e **këmbanës (zilës) së alarmit**. Nëse $\frac{1}{4}$ e një grupi gjuhësor vlerësojnë se një projektligj mund të kërcënoj rëndë marrëdhëniet ndërmjet komuniteteve, atëherë ata mund të aktivizojnë zilën e alarmit. Në këtë mënyrë procedura parlamentare do të ndërpritet dhe propozimi do t'i shkoj Këshillit të ministrave. Nëse Këshilli i ministrave nuk gjen zgjidhje atëherë Qeveria përçahet dhe nuk ka mundësi të dal nga udhëkryqi. Zilja e alarmit është e zbatueshme për të gjitha ligjet, përveç atyre që kërkojnë një shumicë speciale (të cilat votohen çdoherë me konsensus) dhe atyre të bugjetit. Kjo metodë konsiderohet nga shumë flamanë si një shul apo dry që e bllokoi shumicën flamane, ndërsa nga frengjishtfolësit shihet si një lloj e drejte e vetos. Sidoqoftë, këmbana e alarmit përbënë një mekanizëm parandalues (disuaziv). Pra, qëllimi i saj është që të gjitha vendimet të merren në bazë të konsensusit në mes të dy Bashkësive të mëdha.
3. **Barazia gjuhësore në Këshillin e ministrave**, që do të thotë se duhet të ketë po aq ministra holandishtfolës sa frengjishtfolës, përveç kryeministrit i cili mund t'i përket njëres nga këto dy grupe gjuhësore. Meriton të theksohet që Këshilli i ministrave merr vendimet me konsensus. Një barazi të tillë ka edhe në Gjykatën kushtetuese dhe në institucione të tjera federale.

Pra, modeli konsociativ apo konsensual i sistemit federal belg bazohet mbi një konsensus ndërmjet elitave që përfaqësojnë dy grupet e tyre gjuhësore. Duhet përmendur gjithashtu që disa dispozita të njëjta me këto që mbrojnë frengjishtfolësit në nivelin federal janë futur edhe në Bruksel në mënyrë që të mbrohet minoriteti holandishtfolës. Në të vërtetë, mospajtimet më të mëdha ndërmjet Flamanëve dhe Valonëve kanë qenë gjithmonë lidhur me statusin e Brukselit. Brukseli është një lloj enklave në territorin e Flandrës. Për Flamanët, Brukseli ka qenë historikisht i tyre, ndësa në ditët e sotme është i populluar me mbi 80 % frengjishtfolës. Sipas shumë specialistëve të modelit belg, Brukseli është njëri prej faktorëve kryesor që e mbanë të bashkuar Belgjikën sepse asnjëra nga dy Bashkësitë e mëdha nuk dëshiron të heq dorë nga ky qytet.

Modeli federal belg është unik në llojin e tij. Të dy popujtë, flaman dhe valon, kanë arritur në faza të ndryshme, dhe gjithmonë në konsultim të ndërsjellë, për të lëvizur nga një shtet unitar në një shtet

federal. Të dy palët janë mbështetur gjithmonë në dialog paqësor dhe duke respektuar ndjeshmëritë dhe interesat e secilit.

Modeli belg : burim frymëzimi për federalizimin e mundshëm të Maqedonisë ?

Modeli belg paraqet mbi të gjitha një zhvillim paqësor të ngjarjeve. Megjithëse shpeshherë ka grindje dhe mosëmarrëveshje në mes të dy bashkësive të mëdha, prapë se prapë këto të fundit kanë arritur deri më tani të pajtohen duke respektuar shtetin ligjor. Prandaj, Belgjika mund dhe duhet të krenohet me këtë. Për këtë arsye, modeli federal belg shpeshherë është propozuar për të zgjidhur probleme ndërmjet popujëve të ndryshëm, sikurse në rastin e Bosnjë dhe Hercegovinës, të Qiprosë apo edhe së fundi në atë të Ukrainës.

Në rastin e Maqedonisë, modeli federal belg, pa dyshim, do të mund të jetë si një frymëzim për një zgjidhje të problemeve midis Shqiptarëve dhe Sllavo-maqedonëve. Për shkak të ngjashmërive, Belgjika dhe Maqedonia mund të krahasohen ndërmjet tyre në shumë aspekte. Sikurse në Belgjikë, ashtu edhe në Maqedoni kemi tashmë një situatë faktuale të ndarjes në mes Shqiptarëve dhe Sllavo-maqedonëve në shumë drejtime. Për shembull :

1. Shqiptarët jetojnë kryesisht në pjesën perëndimore, kurse Sllavo-maqedonët në pjesën lindore të Maqedonisë.
2. Shkupi i ditëve të sotme mund të krahasohet në aspektin demografik pothuajse me Brukselin.
3. Partitë politike janë të ndara në baza etnike dhe gjuhësore.
4. Përveç përjashtimeve të vogla, edhe mediat janë pothuajse të ndara në ato shqiptare dhe sllavo-maqedone.
5. Shoqëria civile është e ndarë.
6. Nuk ka pothuajse asnjë martesë të përzier ndërmjet Shqiptarëve dhe Sllavo-maqedonëve.

Megjithatë, duhet pasur kujdes që modeli federal belg të mos tentohet të imitohet krejtësisht, shkronjë për shkronjë apo fjalë për fjalë, sepse nuk do të mund të funksiononte në rastin e Maqedonisë. Modeli belg do të mund të jetë burim frymëzimi për Maqedoninë vetëm nëse mbështetet në realitetin në terren, në historinë, kulturën dhe veçoritë e këtij vendi dhe sigurisht nëse do të pranohej nga të dy popujtë shumicë që e përbëjnë Maqedoninë. Pra, duhet të ketë vullnet politikë nga të dyja palët, si ajo shqiptare ashtu edhe nga ajo sllavo-maqedone. Dhe krejtë në fund është me rëndësi të nënvizohet se modeli belg nuk do të ofronte ndoshta një zgjidhje ideale dhe përfundimtare të çështjes shqiptare, por megjithatë do t'u mundësonte Shqiptarëve të Maqedonisë që të jenë plotësisht të barabartë me Sllavo-maqedonët.

Disa nga burimet e shfletuara :

BEAUFAYS Jean & MATAGNE Geoffrey (coord.), *La Belgique en mutation : systèmes politiques et politiques publiques (1968-2008)*, Bruxelles, Bruylant, 2009.

CENTRE D'ÉTUDE DU FÉDÉRALISME (coord.), *Le fédéralisme : approches politique, économique et juridique*, Bruxelles, De Boeck, 1994.

FOURNIER Bernard & REUCHAMPS Min (coord.), *Le fédéralisme en Belgique et au Canada : comparaison sociopolitique*, Bruxelles, De Boeck, 2009.

LIKA Liridon, « Risques et défis sécuritaires de la (non)-intégration des Balkans occidentaux dans l'Union européenne », dans WINTGENS Sophie (dir.), *(In)sécurité ou (in)sécurités ?*, Liège, Éditions Presses Universitaires de Liège, 2015, pp. 117-131.

MABILLE Xavier, *Histoire politique de la Belgique : facteurs et acteurs de changement*, Bruxelles, Éditions du Centre de recherche et d'information socio-politiques (CRISP), Quatrième édition, 2000.

SINARDET Dave, « Le fédéralisme consociatif belg : vecteur d'instabilité ? », *Pouvoirs*, n° 136, 2011, pp. 21-35.

STENGERS Jean, *L'action du Roi en Belgique depuis 1831 : pouvoir et influence*, Bruxelles, Éditions Racine, 2008.

Shtoni në: [Facebook](#) | [Twitter](#) |

Komente (0 dërguar):

Dërgoni komentin 

Emri:

e-mail adresa juaj:

Shto komente:

Dërgo

[LAJME](#) [AKTIVITETE](#) [DIASPORA](#) [MULTIMEDIA](#) [ORGANIZIMI](#) [RINIA](#) [OPINIONE](#) [KONTAKT](#)

[Ballina](#) | [Faqe fillestare](#) | [shto në favoritë](#) | [Rss](#) / [Atom](#) | [Tekst i thjeshtë](#) | [Arhiva](#)